

Yllona Çeleste
Zelj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. _____.2024

Lënda: Propozohet një projektligj për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit

Tiranë

Znj. Kryetare,

Në mbështetje të Kushtetutës dhe të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëngjitur do të gjeni projektligjin “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar*”, të shoqëruar me relacionin e tij.

Kjo nismë ligjvënëse vjen si propozim nga një grup deputetësh të Partisë Demokratike të Shqipërisë, nënshkrimet e të cilëve do t'i gjeni bashkëngjitur.

Në përputhje me Rregulloren, kërkojmë nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji nga Kuvendi i Shqipërisë.

Duke ju falenderuar,

DEPUTET
Oerd Bylykbashi

**RELACION PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË
LIGJIN NR. 10 019, DATË 29.12.2008 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 38, datë 09.12.2022, ka vendosur: “1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës. 2. Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese të votës së emigrantëve në zgjedhjet për Kuvendin, për shkak të boshllëkut ligor. 3. Detyrimin e Kuvendit për plotësimin e boshllëkut ligor brenda një viti.”

Në zbatim të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese paraqiten për shqyrtim dhe për miratim këto ndryshime në Kodin Zgjedhor. Është me rëndësi thelbësore të theksohet se ndërhyrja që propozohet në Kodin Zgjedhor përpinqet të adresojë vetëm detyrimin për Kuvendin që buron nga kjo vendimmarje e Gjykatës Kushtetuese.

Të gjitha aspektet e tjera të cilat do ta bënин një Reformë Zgjedhore të plotë, por edhe që do të kishte mundësinë të jepte impakt në problemet e mëdha të zgjedhjeve në Shqipëri, në mungesë të konsensusit politik, mbetën për fat të keq të pa adresuara. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në adresimin e rekandimeve të raporteve të ODIHR për zgjedhjet e viteve 2021 dhe 2023, problematikat e shpërdorimit të burimeve shtetërore në fushatën zgjedhore, koalicionet parazgjedhore, barazinë e votës dhe çështje që prekin sistemin zgjedhor, patronazhimin dhe shpërdorimin e të dhënavë të zgjedhësve, forcimin e paketës penale lidhur me krimet zgjedhore, etj...

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 12, datë 10.02.2022, miratoi ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për realizimin e reformës zgjedhore” dhe me vendimin nr. 48/2022, miratoi anëtarësinë e tij. Objekti i punës së Komisionit ishte hartimi i ndryshimeve legjislative për reformën zgjedhore, në veçanti trajtimi i rekandimeve të raporteve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e 25 prillit 2021 dhe për zgjedhjet e mëparshme të pa trajtuara, të rekandimeve të institacioneve përgjegjëse për zgjedhjet, të partive politike parlamentare dhe organizatave joftimprurëse. Bazuar në vendimin e Kuvendit nr. 12/2022, Komisioni do të ushtron te veprimtarinë e tij për një periudhë 6 mujore, por ky afat u shty tre herë.

Veprimtaria e Komisionit të Posaçëm përfundoi në datën 21 mars 2024 pa mundur që të paraqiste në Kuvend tekstin e miratuar me konsensus të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor aktual apo eventualisht një Kod i ri Zgjedhor. Partitë politike pjesëmarrëse në Komision nuk arritën të gjejnë gjuhën e përbashkët për çështje dhe formulime konkrete të dispozitave të Kodit Zgjedhor, pavarësisht afatit të gjatë të veprimtarisë së këtij Komisioni. Përfaqësuesit e forcave politike në Komision për amendamentet e Kodit Zgjedhor kishin qëndrime të kundërtë dhe për pasojë ishte evidente mungesa e konsensusit dhe dialogut politik, gjë e cila pas solli edhe përfundimin pa sukses të punës së këtij Komisioni.

Në vijim Kuvendi krijoi dhe institucionalizoi si strukturë brenda Komisionit të Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore, një forum të ri Grupin e Dialogut, me qëllim që, ndër të tjera, të adresonte dhe të mundësonte realizimin e reformës zgjedhore mbi bazën e prioriteteve të mëparshme, të

konsideruara dhe të gjithëpranuara nga forcat politike. Grupi i Dialogut për një periudhë përafërsisht tre mujore ka ushtruar veprimtarinë e tij me objekt përgatitjen e amendamenteve të Kodit Zgjedhor, por rezulton se prej tij nuk është gjetur dakortësia dhe konsensusi politik për çështje dhe elementë të legjisacionit të zgjedhjeve në Shqipëri.

Sa më sipër, duke qenë se si Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore ashtu edhe Grupi i Dialogut nuk kanë mundur të përfundojnë me sukses veprimtarinë e tyre sepse nuk kanë paraqitur asnjë projektligj në Kuvend, Grupi i Deputetëve nismëtarë ndërmerr këtë iniciativë ligjvënëse.

Amendmentet e propozuara kanë si synim të rifomulojnë dispozita të caktuara të Kodit Zgjedhor, në përputhje me arsyetimin dhe dispozitivin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Parimi që reflekton këto formulime është se në Kodin Zgjedhor, siç është bërë në rastin e votimit dhe numërimit elektronik, duhet të gjejnë vend parimet dhe procedurat kryesore normative që për nga natyra e tyre e kanë vardin në Kod, ndërsa autorizohet KQZ-ja, brenda afateve të caktuara kohore, të miratojë bazën e nevojshme nënligjore dhe me natyrë teknike për çdo aspekt të tij dhe më pas ta implementojë atë me sukses.

Koncepti i propozuar në këtë projektligj, në ndryshim nga ato të propozuar në iniciativa ligjore më të hershme është ai i "votimit nga jashtë vendit" duke konsideruar mundësinë e shtrirjes së këtij votimi jo vetëm për shtetasit shqiptarë me banim të përhershëm jashtë vendit por edhe për ata të cilët për arsy studimore, mjekësore apo pune planifikojnë të gjenden jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë ditën e zgjedhjeve.

Ky koncept inovator në raport me iniciativa të tilla analoge edhe të mëparshme reflekton praktikat më të avancuara të vendeve të tjera në këtë drejtim dhe synon ngritjen e një mekanizmi të drejtë, të barabartë dhe të përhershëm për të gjithë ata shtetas të cilët dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e votës nga jashtë vendit.

Duke marrë në konsideratë faktin se zgjedhjet e përgjithshme të planifikuara të mbahen në vitin 2025 janë afér në kohë dhe gjithashtu institucioneve që merren me zgjedhjet do t'u duhet kohë e nevojshme dhe e mjaftueshme për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, propozohet që këto ndryshime ligjore të hyjnë në fuqi menjëherë dhe të botohen në Fletoren Zyrtare.

DEPUTETËT

Orel Bylykushka (Signature)
Elenor Noga (Signature)
Sofia Koto (Signature)
Elda Hoti (Signature)
Jasmin Bećirbegović (Signature)
Tomor Alizobli (Signature)
Begler Gëshlaku (Signature)
Hana Selenica (Signature)
Bujar Leshaj (Signature)

Lindolli Reka (Signature)
Ira Zhupa (Signature)
Karem Vahmutaj (Signature)
Kastrat Dukolli (Signature)
Jedoniu Jashari (Signature)
Xhelal Meiri (Signature)
QANI XHAFA (Signature)
Edmond Spata (Signature)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ Nr. _____ Datë _____ 2024

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 019, DATË 29.12.2008 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81 pika 2, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupei deputetësh,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 24 riformulohet si vijon:

“Neni 24

Kompetencat e KQZ-së lidhur me votimin nga jashtë vendit”

1. KQZ-ja drejton dhe mbikëqyr procesin për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas këtij Kodi.
2. Të drejtën e votës nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë e ka çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që për arsyebim, pune, studimi, shërbimi ushtarak, apo kurimi, ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në datën e zgjedhjeve.
3. Votimi nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë organizohet dhe administrohet nga KQZ-ja në të gjithë komponentët e tij, pasi Rregulatori të ketë miratuar të gjitha aktet nënligjore që kërkojnë përvjetorit nga jashtë vendit, sipas këtij Kodi. Çdo organ tjetër shtetëror shqiptar dhe çdo entitet pjesërisht apo plotësisht shtetëror, apo privat, që përfshihet në këtë proces sipas ligjit, janë të detyruar të zbatojnë rregullat e përcaktuara nga KQZ në përpjekje me këtë Kod.
4. KQZ-ja duhet të marrë vendim me shumicë të cilësuar të votave të Rregulatorit për përfshirjen përmes herës së parës së votimit nga jashtë vendit në procedurat e zakonshme të votimit. Në zgjedhjet vijuese, votimi nga jashtë vendit bëhet automatikisht pjesë përbërëse e procedurave të votimit.
5. Procedurat e detajuara të votimit nga jashtë vendit miratohen me akt normativ të Rregulatorit brenda 60 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.”

Neni 2

Neni 25 riformulohet si vijon:

“Neni 25

Lista e zgjedhësve që votojnë jashtë vendit”

1. Zgjedhësi që voton nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet e radhës për Kuvendin duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit.
2. Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është një listë e vetme në nivel zone zgjedhore dhe përmban listën e shtetasve shqiptare që kanë shprehur vullnetin të votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe janë të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile në territorin e zonës zgjedhore përkatëse.
3. Listat e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë hartohen dhe përdoren rishtaz për çdo palë zgjedhje sipas kritereve, procedurave dhe afateve të përcaktuara në këtë Kod dhe akteve normative të KQZ-së të nxjerra në përputhje me të, dhe janë të vlefshme vetëm për zgjedhjet për të cilat ato janë hartuar. Në çdo rast, KQZ ruan bazën e të dhënave të zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për çdo palë zgjedhje.
4. Regjistrimi i zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë realizohet drejtpërdrejtë nga KQZ-ja. Procesi i hartimit të listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë fillon 100 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 50 ditë para kësaj date. Lista e zgjedhësve pas përfundimit të procesit nuk ndryshon në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak pas afatit të parashikuar në këtë pikë.
5. KQZ, 50 ditë përpara datës së zgjedhjeve, publikon listat e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
6. Shtetasit shqiptarë që janë regjistruar në listat e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pas përfundimit të procedurës së regjistrimit sipas këtij nenit, çregjistrohen nga lista e zgjedhësve brenda vendit që shpallet sipas nenit 56 të këtij Kodi.
7. Në rastet e zhvillimit të zgjedhjeve të përgjithshme sipas nenit 9, pika 5, pika 6, pika 7 ose pika 8 të këtij Kodi, Rregulatori përcakton me akt normativ afatet kohore për listën e zgjedhësve dhe votimin e zgjedhësve me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas së njëjtave kritere dhe procedura që zbatohen për zgjedhjet e zakonshme.
8. Rregulatori miraton aktet e nevojshme normative nënligjore për përbërësit e listës së zgjedhësve jashtë vendit, dokumentacionin e nevojshëm si dhe modalitetet dhe rregullat e tjera teknike të hartimit të kësaj liste.

9. Komisioneri dhe Ministri përgjegjës për gjendjen civile, brenda 60 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcaktojnë me akt të përbashkët mënyrën e bashkëpunimit mes KQZ-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për çregjistrimin e shtetasve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në listën e zgjedhësve brenda vendit.

10. KQZ përzgjedh me procedurë të hapur një operator postar me eksperiencë dhe reputacion ndërkombëtar që siguron postë të shpejtë”.

Neni 3

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/1

Votimi nga jashtë vendit dhe rezultati zgjedhor”

1. Votimi nga jashtë vendit quhet i çelur nga dita që KQZ-ja i mundëson zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë materialin zgjedhor që u nevojitet për votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përfshirë fletën e votimit dhe dokumentacionin udhëzues.

2. Votimi nga jashtë vendit mbyllt në ditën e votimit, dhe vërtetohet nga data e dorëzimit të zarfit që përmban fletën e votimit në shërbimin postar. KQZ-ja nuk mund të pranojë dhe përfshijë në numërim asnjë fletë votimi të mbërritur më vonë se 72 ore pas datës së zgjedhjeve.

3. KQZ-ja mundëson fletët e votimit dhe çdo material tjeter zgjedhor dhe informativ për çdo zgjedhës të regjistruar në listat e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Fleta e votimit pasqyron në mënyrë identike përmbajtjen e fletës së votimit që përdoret brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. Fletët e votimit të plotësuara dhe të sekretuara dërgohen në adresën zyrtare të KQZ-së, nëpërmjet shërbimit postar me shpenzimet e zgjedhësit. Zgjedhesi duhet të respektojë rregullat për ruajtjen e fshehtësisë së votës gjatë dërgimit të materialit zgjedhor, sipas udhëzimeve të KQZ. Cënimi i fshehtësisë së votës passjell pavlefshmërinë e fletës së votimit.

5. Fletët e votimit të dërguara nga zgjedhësit që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të administruara, numërohen në ambientet e KQZ-së. Fletët e votimit të dërguara nga zgjedhësit jashtë vendit në momentin e mbërritjes në KQZ ndahen sipas zonës zgjedhore të vendbanimit më të fundit të zgjedhësit para largimit nga Shqipëria. Procesi i numërimit dhe vlerësimit të tyre kryet nga administrata e KQZ-së dhe tabelohen në tabelën e rezultateve të zonës zgjedhore përkatëse. Rregulatori përcakton me akt nënligjor dokumentacionin, mënyrën e plotësimit të tij dhe çdo aspekt tjeter për administrimin, numërimin, vlerësimin e votës dhe tabelimin e rezultatit zgjedhor sipas këtij Kodi.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetare

Lindita Nikolla